



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 400-5755/15
Kaçanik, 27.02.2015

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 7 të Ligjit nr.05/L-001.- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, të nenit 34.5 lidhur me nenin 61.1 dhe 66 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2015, mori këtë:

V E N D I M
PËR BARTJEN E MJETEVE VETANAKE TË PA SHPENZUARA NË BUXHETIN E KOMUNËS
PËR NË VITIN 2015.

1. Me këtë Vendim Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2015, pas bartjes së mjeteve të pa shpenzuara nga viti fiskal 2014 në shumë prej **152,163.21** euro, do të arrinë shumën e përgjithshme prej **7,010,589** euro.

2. Mjete e pa shpenzuara në shumë prej 152,154.74 euro do të barten: Paga dhe Mëditje të Shkollave dhe Mesme Profesionale shuma prej **672.05** euro ; Mallëra dhe Shërbime shuma prej **11,129.00** euro (Mallëra dhe Shërbime 7,466.89 euro plus Shpenzime Komuna shuma prej 3,662.11 euro =11,129 euro) të Shërbimet Publike ; Subvencione dhe Transfere shuma prej **5,279.30** euro do të barten tek buxheti i Zyrës së Kryetarit dhe shuma prej **4,000** euro do të bartet te programi buxhetor i Bujqësisë ; Shpenzimet kapitale në shumë prej **40,000** euro do të barten te Zyra e Kryetarit , shuma prej **21,082.86** euro do të barten te programi buxhetor i Planifikimit Urban dhe shuma prej **70,000** euro do të bartet te programi buxhetor i Arsimit dhe Kulturës.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë edhe Shtojcat A dhe B të pasqyrave tabelare e bilanceve të pa shpenzuara nga viti fiskal 2014 dhe rindarja e mjeteve të bartura në buxhetin e vitit 2015.

4.Për realizimin e këtij vendimi, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit pas miratimit në Kuvendin Komunal.

5. Ky Vendim hynë në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Me këtë Vendim të njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit,
3. Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi